



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

---

Numri i lëndës: 2018:025538

Datë: 08.10.2018

Numri i dokumentit: 00148248

**P.nr.671/17**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm**, gjyqtari i vetëm gjykues Mentor Bajraktari, me procesmbajtësen Nushe Kadrija – sekretare juridike pranë kësaj gjykate, në lëndën penale kundër të akuzuarit P.De. nga fshati M., Komuna e Gj. , për shkak të veprës penale dëmtimi apo asgjësimi i pasurisë nga neni 333 par.1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë-Departamenti përgjithshëm, me numër PP.nr.840/17, të datës 19.09.2017, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar me datën 08.10.2018, në prezencën e Prokurores së shtetit Mone Sylja si dhe të akuzuarit, në të njëjtën datë mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**Ndaj të akuzuarit:**

**P.D.** nga i ati F., e ëma P., e gjinisë Ndata e lindjes... në fshatin M., Komuna e Gjakovës, ku edhe tani jeton, i martuar, baba i 7 fëmijëve, ka të kryer 2 vite të shkollës fillore, pensionist, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar-shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal: .....

Në kuptim të nenit 363 par.1 nënpar.1.1 të KPP-së,

**R E F U Z O H E T A K U Z A**

Sepse me datën 22.05.2017, rreth orës 17:00/h, në fshatin F., Komuna e Gjakovës, pikërisht afër H.. "...", dëmton apo e bën të papërdorshme pasurinë e personit tjetër, në atë mënyrë që i akuzuari lëshon bagëtinë për të kullotur në pronën-livadhin e të dëmtuarit Sh.H. nga Gjakova dhe atë dhjetë lopë, katër dhi dhe katër kuaj, me ç'rast të dëmtuarit i shkakton dëm të konsiderueshëm material.

Këso dore kishte për të kryer veprën penale: asgjësim apo dëmtimit të pasurisë nga neni 333 par.1 të KPRK-së.

Për shkak se Prokurorja e shtetit e Prokurorisë Themelore në Gjakovë, në shqyrtimin fillestar është tërhequr nga akuza.

I dëmtuari Sh.(B.) H., Gj. me banim në rrugën "Y.M. " p.n, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko - civil.

Shpenzimet e procedurës penale bijën në llogari të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Gjakovë – Departamenti i përgjithshëm, pranë kësaj gjykate ka ngritur aktakuzën me numër PP.nr.799/2017 të datës 12.10.2017, kundër të akuzuarit P. D. nga fshati M., Komuna e Gj., për shkak të veprës penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 par.1 të KPRK-së.

Gjatë seancës publike të shqyrtimit fillestar, Prokurorja e shtetit Mone Sylja, ka deklaruar se: pas deklarimit të të akuzuarit si dhe pas analizimit të shkresave të lëndës si dhe duke marrë për bazë që vepra penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë mund ta kryen kushdo që asgjëson apo bënë të papërdorshme pasurinë e personit tjetër në rrethana tjera nga ato të përcaktuara me nenin 334 të KPRK-së, pra vepra penale kryhet me dashje direkt dhe kryerësi është penalisht përgjegjës vetëm nëse ka vepruar me dashje, domethënë ka qenë i vetëdijshëm se ndaj sendit po ndërmerr një veprim të cilin mund ta dëmtojë, t'ia asgjësojë ose ta bëjë të papërdorshëm dhe nëse dëshiron ose pajtohet që një pasojë e tillë të shkaktohet andaj duke marrë për bazë deklarinimin e të akuzuarit i cili ka theksuar se në ditën kritike nuk ka qenë duke i ruajtur bagëtitë por ka qenë i mituri përkatësisht nipi i tij P.D. i cili ka qenë i moshës 14 vjeçare, pra nuk ka qenë veprimi i të akuzuarit pra i akuzuari nuk ka ndërmarrë kurrfarë veprimi në këtë rast si dhe duke marrë për bazë që ndaj të dëmtuarit është shkaktuar dëm dhe ky dëm mund të kërkohej edhe në çështje civile, deklaroj se tërhiqem nga aktakuza PP.nr.799/17 e datës 12.10.2017 kundër të akuzuarit P.D. nga fshati M., Komuna e Gjakovës, për shkak të veprës penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 par.1 i KPRK-së.

Andaj gjykata, duke pas parasysh se Prokurorja e shtetit është tërhequr nga aktakuza dhe nga ndjekja penale në shqyrtimin fillestar kundër të akuzuarit P.D., nga fshati M., Komuna e Gj., për shkak të veprës penale: asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 par.1 të KPRK-së, në kuptim të nenit 363 par.1 nënpar.1.1 të KPP-së, mori aktgjykim refuzues në këtë çështje penale dhe vendosi si në dispozitivin të këtij aktgjykimi, pasi që janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore të parapara me këtë dispozitë ligjore.

Vendimi mbi udhëzimin e palës së dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest civil është marrë në kuptim të dispozitës së nenit 463 par.3 lidhur me par.1 të KPP-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale u murr në kuptim të nenit 454 par.1 të KPP-së.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË**  
**- Departamenti i Përgjithshëm -**  
**P.nr.671/17, më datë 08.10.2018**

**Procesmbajtësja,**  
**Nushe Kadrija**

**Gjyqtari i vetëm gjykses,**  
**Mentor Bajraktari**

**UDHËZIMI JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.